



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-06061-9881 dt. 13/03/ 2025

Në bazë të nenit 52 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje lokale, nenit 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 12 pika 12.2 dhe nenit 21 pika 21.2 të Rregullores të punës së Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Drenasit z. Bekim Lestrani, me 19.03.2025 (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Bordit të Drejtorëve të Komunës.

THËRRET
Mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbalin e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më datën 19.02.2025;
2. Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023;
3. Raporti vjetor i KRM "Pastrimi", për vitin 2024;
4. Raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve-Drenas";
5. Plani lokal i veprimtimit për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave dhe vajzave Drenas 2025-2028;
6. Draft-propozim për ndryshim-plotësim të rregullores, për taksa, tarifa, ngarkesa, dhe gjoha 02 nr.400/03-62198 datës 28.12.2023;
7. Të ndryshme.

Drenas, 13.03.2025



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Bekim Lestrani
Bekim Lestrani



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 0601.9343 dt. 10/03/ 2025

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 19.02.2025, e cila filloi në ora 10:00.

Mbledhjen e kryesoi: Bekim Lestrani-kryesues.

Kryesuesi i Kuvendit Bekim Lestrani, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Malësore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV), Hamit Kastrati (PDK).

Të pranishëm ishin edhe: Valentina Leku-Gashi, kryetare e Komisionit për emërtim të rrugëve dhe Safet Hoxha, përfaqësues nga Drejtoria e Gjeodezisë.

Mbledhja do të këtë

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 22.01.2025;
2. Raporti i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të palëve për emërtim të rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Komunën e Drenasit për vitin 2024;
3. Propozim-vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa dhe hodhi në votim rendin e ditës dhe kaloi me vota unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e parë të rendit të ditës 1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i dt. 22.01.2025, diskutime nuk pati dhe kaloi në mënyrë unanime.

Valentina Leku, kryetare e Komisionit për emërtim të rrugëve, përshëndetje për të gjithë. U bënë gati dy vjet që është formuar ky komision për emërtimin e rrugëve në kohën kur ka pas pauzë Kuvendi nuk kemi mbajtur asnjë mbledhje. Për afërsisht janë mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje deri tani dhe jemi në proces të hartimit të raportit përfundimtar, përafërsisht dyzet (40)

rrugë i kemi përgatit deri me tani për me i sjell në seancën e Kuvendit nëse edhe ju pajtoheni me i kaluar.

Arbër Halilaj, tha se vetëm më interesoi si informatë deklaruar, që i keni shqyrtuar rreth 40 kërkesa, a keni pasur ankesa ose konteste diçka prej palëve.

Valentina Leku, po kemi shumë sfida me persona që na akuzojnë, por ne jemi munduar si komision me bërë punën tonë, këto rrugët që nuk kanë probleme kemi me i sjell në këtë seancë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, kemi një listë për emërtime të rrugëve që e ka kaluar Kuvendi i Drenasit, por që ka ngelur në Ministri dhe është refuzuar ligjshmëria për shkak të një vendimi që është dashtë me marr të bordi për kadastër e gjeodezi. Kryesuesi, tha së a i keni parë raportet dhe procesverbalet paraprak unë kam qenë në atë komision dhe i kemi bërë rreth 82 vizita nëpër fshatrat e Drenasit.

Valentina Leku, tha se, për emërtim të rrugëve me shumicën prej anëtareve të komisionit të kaluar kemi kontaktuar, sepse ne anëtarët që jemi tani jemi për here të par dhe kërkuam ndihmë prej shumë anëtarëve që ishin më herët, meqenëse ato janë të gatshëm prej komisionit të juaj i kam parë, por nuk i kam shqyrtuar janë më shumë se 2000 kërkesa.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, ideja është me ju lehtësuar punën se janë raportet, procesverbalet, të cilat mund të ju ndihmojnë sa do pak punën për disa kërkesa që janë përsëritë.

Valentina Leku, tha se, e kam parë edhe raportin e juaj dhe ka qenë shumë mirë i bazuar në ligj për çdo gjë, mirëpo arsyeja pse e kanë kthyer ka qenë, sepse e keni dërguar si pako me kërkesa. Ndërsa vetëm tri prej tyre nuk i kanë plotësuar kriteret dhe ter pakon e kanë kthyer në pikën fillestare dhe ne për këtë arsye është dashtë me hollësisht me shikuar për mos me ardhur deri te kjo pikë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e dytë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën 3. Propozim-vendim për plotësim-ndryshimin e Vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, pasi nuk pati vërejtje sugjerime, kryesuesi hodhi në votim pikën e tretë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend në mënyrë unanime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, me kërkesën e Safet Hoxhës, përfaqësues nga Drejtoria e Gjeodezisë hapi për diskutim pikën 4, ku kemi një kërkesë për këmbim të pronës në Terstenik.

Arbër Halilaj, përshëndetje për të gjithë vetëm dua të theksoi që parimisht jam për, por kur një parcelë private jepet për rrugë ose për çfarë do interesi të përgjithshëm, natyrisht që ishte dashtë me pas një vlerësim që e bënë Ministria e Financave.

Vlerësuesit e licencuar ishte dashtë të këmbehen me një pronë si ka kërkuar konkretisht ky personi, kështu që nuk shoh këtu asgjë kontestuese dhe jam që kjo të procedohet për në Kuvend.

Safete Hoxha, tha se ne si drejtori e kemi pranuar kërkesën nga Lutfi Bytyqi për këmbim të pronës e cila është shtruar asfalt në pjesën e pronës së tij, që realisht ne si Komunë është interes i jonë me e bërë këmbimin se sa me vazhduar procedura ligjore. Ne e dimë që ai kontekstin e fiton edhe përveçse e fiton kontestin mund të kërkon edhe fitimin e humbur dhe dëmet që i kemi shkaktuar pronës se tij.

Pse ne e kemi paraqit gjendjen ekzistuese dhe kërkesën që ka kërkuar me e bërë këmbimin nuk do të thotë që Departamenti i shpronësimit që janë ekspert për këtë çështje që është në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që e bënë shpronësimin dhe vlerësimin e pronave, në bazë të vlerësimit të pronave s'do me thënë që e jep sa e kemi konstatuar ne.

Ne e kemi konstatuar si e ka gjendjen në terren 6 ari e 43 metra, në bazë të vlerësimit ka mundësi që sipërfaqja të jepet me shumë ose me pak, kështu që ne vetëm e kemi propozuar për Kuvend me vendosë si pikë të rendit të ditës dhe pastaj vazhdojmë me procedurat tjera.

Hamit Haxhiu, unë në parim jam që të gjitha ato pronat që janë marrë për interes të Komunës, duhet patjetër me u kompensuar dhe jam pro kësaj pike.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hodhi në votim pikën e katërt shtesë të rendit të ditës, e cila u rekomandua për Kuvend nga të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Lestrani, hapi për diskutim pikën e pestë Të ndryshme. Diskutime nuk pati.

Mbledhja përfundoi në ora 10:35.


Procesmbajtësja:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Bekim Lestrani



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Komuna/Opština/Municipality Drenas (Gilloç)

Zyra e Kryetarit

01 Nr. 400/01-9435 Dt. 11/03/2025



Për: Zyrtën e Kuvendit të Komunës

Nga : Ramiz Lladrovi, Kryetar i Komunës së Drenasit

Lënda: Raport për implementimin e rekomandimeve të Raportit të auditimit me temë: "Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023"

Në pajtim me nenin 14 të Rregullores së punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimt, si dhe duke u mbështetur në Procedurat Standarde të Trajimit të Rekomandimeve të Zyrtës Kombëtare të Auditimit, po ju dërgojmë Raport për zbatimin e Rekomandimeve që dalin nga Raporti i auditimit me temën "Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Drenasit për vitin fiskal 2023"

RAPORT

PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE QË DALIN NGA RAPORTI I AUDITIMIT TË PAQYRAVE VIETORE FINANCIARE TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN FISKAL 2023

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatim të rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfidat e hasura në zbatimin e rekomandimit
1 A1	Çështja A1 - Mangësi në përgatitjen e paramases dhe parallogarisë	Rregullorja Nr.001/2022 për prokurim publik, neni 19 përcakton që AK do të specifikoj në dosjen e tenderit të gjitha specifikimet teknike të cilat çdo tender duhet ti përmbush. Specifikimet teknike do të përshkruajnë dhe përkufizojnë, në mënyrë jo-diskriminuese, karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës, siç janë cilësia, performanca, kërkesat e dizajnit, dimensionet, siguria, siguri i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënimi dhe etiketimi. Specifikimet duhet të jenë të qarta, sakta dhe precize dhe të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë	Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar funksionimin e plotë të kontrolleve që kanë të bëjnë me përgatitjen e paramases dhe parallogarisë	Zyra e Prokurimit është duke kontrolluar në vazhdimësi specifikat dhe kthehen vazhdimisht ato të cilat vërehen gjëjtet.	Pjesërisht	Ka llojllojshmëri të punëve dhe të kontratave .

		paqartësi rreth natyrës së malhrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Tek aktiviteti i prokurimit : Instalimi i nxemjeve nëpër Qendrat e mjeksisë familjare dhe ambulantat e mjeksisë familjare, kontrata e nënshkruar me datë 26.05.2023, në vlerë 69,737€, kemi vërejtur se kishte mangësi sa i përket përgatitjes së paramases dhe parallogaris. Në dy pozicione nuk ishin definuar qartë paramasa dhe parallogaria: Tek paramasa në pozicionin 1.1 ishte paraparë "furnizimi dhe vendosja e klimave për ngrohje dhe ftohje përfshirë funksionalizimin e tyre. Specifikimet teknike përfshinin furnizimin me 8 copë klima 12BTU, 9 copë klima 18BTU dhe 9 copë klima 24 BTU". Pra është dashur të ndahen në pozicione të ndryshme. Po ashtu tek pozicioni 1.3 ku përfshihet "furnizimi dhe vendosja e				
--	--	--	--	--	--	--

		klimeve në vendin e caktuar. Ky pozicion është dashur të jetë më i detajuar sa i përket specifikimeve teknike, sepse kjo shkakton paqartësi tek ofertuesit. Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.			
2 B1	Çështja B1 - Mungesa e projekteve ekzekutuese	Rregullorja Nr.001/2022 për prokurim publik, neni 19.17 kërkon që "Specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten". "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për hartimin e projektit ekzekutues dhe i cili në mënyrë mandatore duhet ti bashkëngjitet specifikave teknike të cilat janë pjesë e dosjes së tenderit". Asnjë Autoriteti Kontraktues nuk i lejohej që të lëshojë dokumentacionin e tenderit pa bashkangjitur përshkrimin e hollësishëm të projektit. Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se në katër (4) raste për projekte kapitale, komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit që kanë të bëjnë me punë, të mos initohen procedurat pa u siguruar specifiika të qarta sipas projektit ekzekutues, të cilat do të ndikojnë në eliminimin e vonesave dhe të kostove shtesë.	Drejtoria e Infrastrukturës Publike ka lidhur kontratë për hartim të projekteve me nr. 611-23/6859-2-1-1, të datës 17.8.2023 e cila është valide.	I zbatuar

	përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë: 1) Projekti "Ndërtimi, zgjerimi dhe rikonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Drenas" - Projekt trevjeçar. 2) Projekti "Infrastruktura në Komoran I, II, III, IV". 3) Projekti "Asfaltimi i rrugëve në fshatin Verbovc, Shtutic, Polluzhë dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Tërstenik I, II dhe Gillobar" - Projekt dyvjeçar. 4) Projekti "Ndërtimi i parkingjeve dhe pllatojeve: SH.Galica, Gani Syla, 7 Marsi, XH.Lladrovci, H Prishtina dhe SH.Polluzh".						
3	Çështja A2 - Mangësi në databazën e tatimit në pronë	Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definoi: "Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësisia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaroi këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i	Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve në procesin e inicimit të aktivitetit të prokurimit.	Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korrigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër	Në bashkpunim me zyrën e gjendjes civile janë ndërmarr hapa për evidentimin e numrave personal të tatimpaguesve. Te të gjithë ata tatimpagues te cilët nuk kanë numër personal te regjistruar, nuk	Pjesërisht	I vazhdueshë m për shkak të natyrës së punës, sepse çdo vit bëhen regjistrime të reja në

		lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni. Nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 122 personave iu ishte bërë zbritja e tatimit në pronë pa numër personal. Kjo ka ndodhur për shkak te funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.	personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.	ekzekutohet zbritja e tatimit ne prone. Sistemi I tatimit ne prone ka mangësi prandaj këtë vit DTP është duke punuar sistematikisht në përmirësimin e defekteve në system. Prandaj ka raste ku në sistem figuron banimi parësor por nuk ekzekutohet zbritja.		teren, bëhen trashigimi, shitëblerje dhe vetdeklarim të banimit primar.
4	Çështja A3 - Monitorimi i	Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e	Të gjithë menaxherët e kontratave janë njoftuar	Pjesërisht	Mungesa e njohurive

A3	menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit	Publik parashihet se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistruar e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.	projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	për të regjistruar pagesat në sistemin të prokurimit elektronik.		në përdorimin e e-prokurimit nga menaxheret e projekteve.
		Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.				
5	Çështja B2 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike	Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Megjithatë këto shpenzimet derivojnë nga kontratat kolektive-sektoriale të Arsimit dhe Shëndetësisë, ku ne nuk jemi palë e marrëveshjeve, dhe në pambundësi të buxhetimit (sankcionuar me qarkoret buxhetore), këto obligime do të ezeekutohen nga kategoria	I pa zbatuar	Obligimet e dala nga këto kontrata është e pamundur të administrohen nga ne. Niveli qendror /ministritë
B2						

				gjeëgjese nuk kanë ndërmarr asnjë veprim për të gjetur zgjidhje
	adekuate nga burojnë ,për aq së është e mundur në mundësitë buxhetore dhe kompetencat tona.			
SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 181,315€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 98,751€, nga mallrat dhe shërbimet 58,248€, si dhe nga subvencionet 24,316€ Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.				